



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


1 DHJETOR 2023

** Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e Komisionit Evropian për harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) ra me 1.6 pikë në muajin nëntor, duke shënuar nivelin 109.3. Niveli aktual i TNE-së qëndron rreth 9 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 1). Rënia e TNE-së këtë muaj u ndikua kryesisht nga vlera më e ulët e treguesit të besimit në sektorin e *shërbimeve dhe të tregtisë*. Negativisht kontribuoi edhe rënia e besimit në sektorët e *industrisë* dhe rënia e besimit *konsumator*. Në të kundërt, treguesi i besimit të *ndërtimit* dha kontribut pozitiv këtë muaj (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) ra me 0.6 pikë përqindje në muajin nëntor, duke shënuar rënie më të ngadaltë se në muajin e mëparshëm. Megjithatë, TBI-ja vijon të qëndrojë mbi mesataren historike (Grafiku 2). Bizneset e industrisë u shprehën më pesimiste lidhur me *kontratat porositëse*, kryesisht ato të lidhura me eksportin. Nga ana tjetër, ato raportuan të përmirësuar *prodhimin aktual* industrial. Pritjet e bizneseve të industrisë për *prodhimin* në të ardhmen kanë mbetur të pandryshuara nga niveli i një muaji më parë, ndërsa pritjet për punësimin në të ardhmen janë në rënie. Pritjet për çmimet e produkteve që do të prodhojnë në të ardhmen janë vlerësuar me rritje këtë muaj (Tabelë 2, sektori i industrisë).

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) regjistroi rritje me 4.4 pikë përqindje në nëntor, duke qëndruar rreth 20 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 2). Rritja e TBN-së u përcaktua kryesisht nga vlerësime më optimiste për *aktivitetin aktual ndërtues*. Vlerësimi për nivelin e *porosive* regjistroi rritje, por në masë më të ulët. Gjithashtu, pritjet për *punësimin* dhe çmimet që do të vendosin në të ardhmen kanë regjistruar rritje (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) ra me 4.4 pikë përqindje në nëntor, por duke vijuar të qëndrojë mbi mesataren historike, me 12.3 pikë përqindje (Grafik 2). Në rënien e TBSH-së kontribuuan vlerësimet më pak optimiste të bizneseve si për *ecurinë aktuale të aktivitetit* të tyre, ashtu edhe për *nivelin aktual të kërkesës*. Pritjet për *kërkesën* dhe nivelin e punësimit në të ardhmen vlerësohen në rritje nga këto biznese. Pritjet e tyre për *ecurinë e çmimeve* në të ardhmen janë në rritje (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) regjistroi rënie me 1.7 pikë përqindje në muajin nëntor. Aktualisht, niveli i TBT-së qëndron rreth 8 pikë mbi mesataren historike (Grafik 2). Në rënien mujore të TBT-së ndikuan kryesisht vlerësimet më pak pozitive për *ecurinë aktuale të biznesit* të tyre. Nga ana tjetër, pritjet për *punësimin* në të ardhmen kanë mbetur pothuaj në të njëjtin nivel me një muaj më parë. Pritjet për çmimet në të ardhmen u vlerësuan me rritje të lehtë (Tabelë 2, sektori i tregtisë).


Treguesi i besimit konsumator (TBK) regjistroi një rënie të lehtë me 0.7 pikë përqindje në muajin nëntor. Aktualisht, niveli i TBK-së është 2 pikë përqindje mbi mesataren e tij historike (Grafik 2). Konsumatorët vlerësuan me rënie *blerjet në shumën të mëdha*. Nga ana tjetër, ata ishin më optimistë lidhur me *situatën financiare dhe ekonomike* të vendit në të ardhmen (Tabelë 2, konsumatorët).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumta të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2023					Situata aktuale	
	min	mes	maks	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Koniunkturale**	Strukturore***
Industri	-60.7	-11.0	6.5	1.9	-3.1	-0.6	-4.2	-4.7	↓	+
Ndërtim	-58.1	-25.9	9.8	-2.0	1.8	-8.6	-10.4	-6.0	↑	++
Shërbime	-45.5	7.1	35.3	22.7	30.2	25.5	24.2	19.8	↓	+
Tregti	-32.7	-1.4	17.3	13.6	10.8	10.5	8.2	6.5	↓	+
Konsumator	-40.3	-26.6	-16.3	-27.0	-27.3	-26.9	-24.2	-24.9	↓	+

Burimi: Vrojimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

***) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

****) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2023								
	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	21.4	25.6	29.4	26.2	23.7	20.1	21.8	12.6	16.1
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-8.1	-1.5	-4.8	-3.9	-8.9	-13.3	-10.6	-11.6	-10.1
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-9.0	-10.2	-5.3	-2.7	-8.9	-16.0	-13.0	-13.5	-20.2
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-0.9	-4.2	-2.6	1.2	0.0	3.7	3.2	-3.3	-3.3
Prodhimi pritje (pyetja 5)	40.5	37.5	33.3	29.4	31.1	24.7	29.8	31.8	31.7
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	15.7	17.3	18.7	18.1	16.6	9.1	-9.2	9.4	22.5
Punësimi pritje (pyetja 7)	14.9	16.8	15.8	12.3	8.6	10.7	9.4	10.1	8.3
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	22.5	21.7	29.1	30.9	14.9	22.2	7.3	7.5	15.2
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-16.8	-16.0	-14.5	-11.3	-18.9	-18.6	-24.4	-28.2	-27.2
Punësimi pritje (pyetja 4)	18.8	15.6	13.7	15.8	9.4	12.7	5.2	10.7	12.2
Çmimet pritje (pyetja 5)	29.0	19.6	19.8	26.8	26.0	17.5	20.5	8.2	14.6
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	25.1	23.1	39.2	32.0	20.0	30.2	25.5	23.7	17.4
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	27.4	26.0	31.5	34.0	25.3	30.2	25.4	24.8	22.2
Kërkesa pritje (pyetja 3)	36.1	28.8	29.1	28.9	29.6	30.7	25.3	29.4	32.6
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	9.8	12.3	16.6	16.2	15.0	11.3	6.0	4.2	7.3
Punësimi pritje (pyetja 5)	21.3	9.3	13.0	12.8	11.3	11.2	10.2	12.3	10.9
Çmimet pritje (pyetja 6)	19.6	7.8	13.9	13.4	15.8	17.5	14.0	12.7	16.8
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	14.4	16.1	21.0	20.0	24.0	18.8	18.6	13.9	10.3
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	2.6	3.7	5.0	0.5	0.3	4.3	0.8	2.1	3.1
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	24.7	29.3	22.9	25.1	16.8	21.4	23.1	29.2	21.7
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	26.4	26.9	26.5	26.4	18.8	23.9	17.6	27.4	25.4
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	5.1	5.4	3.4	5.5	3.2	2.8	2.4	2.6	2.7
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	13.9	10.6	23.3	13.5	18.4	7.6	14.8	9.1	9.6
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-14.7	-15.2	-13.8	-13.7	-15.8	-14.6	-13.5	-11.6	-11.0
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	4.2	6.2	4.3	4.1	1.6	0.6	1.8	4.2	4.6
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-27.4	-24.9	-23.9	-22.2	-23.8	-23.4	-21.8	-19.8	-19.1
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	0.2	2.8	2.6	1.0	-0.2	0.8	0.3	1.0	3.9
Çmimet aktuale (pyetja 5)	45.7	49.7	43.9	46.5	50.9	51.4	46.7	46.1	46.8
Çmimet pritje (pyetja 6)	-6.5	-4.1	-7.6	-5.4	-0.1	4.2	-3.6	-7.0	-5.6
Papunësia pritje (pyetja 7)	3.1	-1.3	-1.0	-0.2	2.4	1.3	-0.1	-4.0	0.3
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-62.5	-59.0	-60.3	-58.0	-61.4	-61.1	-61.0	-57.4	-59.7
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-48.6	-48.1	-48.8	-47.5	-47.8	-49.3	-48.7	-44.6	-48.3
Kursimi aktual (pyetja 10)	-44.7	-41.9	-42.9	-43.6	-45.3	-44.0	-45.2	-44.5	-45.7
Kursimi pritje (pyetja 11)	-40.1	-40.1	-39.6	-39.4	-42.6	-42.9	-43.3	-41.5	-42.2
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	4.0	3.2	4.0	2.6	0.1	-0.6	-0.4	3.8	1.7

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilat kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.